

V E N D I M
Nr.559, datë 1.8.2003

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.96, DATË 13.2.2003 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE "PËR PËRCAKTIMIN, PËR VITIN 2003, TË NUMRIT TË PUNONJËSVE TË
INSTITUCIONEVE BUXHETORE" DHE PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E
VITIT 2003, MIRATUAR PËR MINISTRINË E EKONOMISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 dhe 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë" dhe të nenit 8 të ligjit nr.8983, datë 20.12.2002 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2003", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Numri i punonjësve të Ministrisë së Ekonomisë, i përcaktuar në pikën 7 të listës, që i bashkëlidhet vendimit nr.96, datë 13.2.2003 të Këshillit të Ministrave, duke filluar nga data 1 gusht 2003, bëhet 195.
2. Ministrisë së Ekonomisë në buxhetin e miratuar për vitin 2003, në zërin "Shpenzime korrente", t'i shtohet fondi prej 1 000 000 (një milion) lekësh.
3. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
FATOS NANO